



SHPIRTTHYER...!



**MYSLIMAN,
POR JO BESIMTAR...!**



**DIJA, DIJETARI DHE MINBERI,
- KY VEND I SHENJTË!**

Viti XV - Nr. 1 (167),
Janar, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

NJERIU PA FÉ, PA ZOT, NË LIRI ABSOLUTE E PA KUFI, E KA HUMBUR BUSULLËN...



XHAMIA NË KALANË E SHKODRËS, PJESË E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E MYSLIMANËVE SHQIPTARË

Fillimisht do të thoja se objekti i xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut në kalanë e Shkodrës është pjesë e pandarë e kulturës dhe e trashëgimisë islame të vendit tonë, pra pjesë e trashëgimisë islame shqiptare. Unë besoj se së pari është detyrë e shtetit shqiptar, e ministrisë së kulturës që të merret me restaurimin e kësaj xhamie të vjetër shekullore, e cila përkthen më së miri shpirtin dhe identitetin islam të komunitetit më të madh fetar në Shkodër, pra komunitetit mysliman.



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia e plotë i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, i Cili urdhëron në Kur'anin Famëlartë: “Dije se nuk ka Zot tjetër pos All-llahut”. – (Muhammed: 19).

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës tonë. Ma të Miri dhe Ma të Shtrenjtit, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), i cili na tregon nga Zoti i gjithësisë, në hadithin kudsi, se Ai ka thënë: [Ka thënë All-llahu i Madhëruar: “Më ka sharë i biri i Ademit, njëkohë që nuk i takon të më shajë dhe, ka gënjyer për Mua, njëkohë që nuk i takon të gënjejë! E, përsa i përket sharjes së tij, ajo qëndron në fjalën e tij se, Unë “kam djalë”, ndërkohë që Unë jam All-llahu, i Vetmi, Mua më mbështetet çdo gjë, nuk kam lindur njeri dhe nuk jam lindur prej kujt dhe, askush nuk është i barabartë me Mua! Ndërsa gënjeshtria e tij për mua, ajo qëndron në fjalën e tij: “Zoti nuk do më ringjallë, siç më ka krijuar!” Fillimi i krijimit nuk është më i lehtë për Mua sesa ringjallja e tij!”] – (Ahmedi, Bukhariu dhe Nesaiu, nga Ebu Hurejra).

TË DASHUR E TË NDERUAR VËLLEZËR BESIMTARË DHE JU MOTRA TË NDERUARA,

Sivjet, ne përkujtojmë së bashku 10 vjetorin e inaugurimit të xhamisë së Parrucës. Në pamje të parë, kjo është një datë e zakonshme dhe një event i papërfillshëm, aq më shumë në një komunitet vlerash që tërhiqet padrejtësisht drejt hutimit, për të mos pasur në jetën e tij as data, as evente, as ngjarje, as ndodhi e personazhe, që ia vlen të përkujtohen vit pas vite dhe

NJERIU PA FÉ, PA ZOT, NË LIRI ABSOLUTE E PA KUFÏ, E KA HUMBUR BUSULLËN...

dekadë pas dekade...

Xhamia e Parrucës është një ndër këto stacione, data, personazhe, ngjarje dhe mesazhe, që nuk duhen harruar asnjëherë në jetën tonë komunitare, për shumë e shumë arsye!

Në fakt, ka disa ditë që në mendimet e mia sillen disa ajete dhe hadithe, që më tërheqin t'i përmend kudo, si pika të rëndësishme të udhëzimit tonë në jetë.

Ajeti i parë, që lidhet edhe me xhaminë tonë, simbolikën e saj dhe përvjetorin e saj të dhjetë, është

ka dëshmuar veten si krijesë për t'u pasur frikë për mungesën e boshtit të tij identitar; vrastar, ziliqar, imoral, i shthurur, i korruptuar, gënjeshtar, zullumqar i madh!

Njeriu abuzues me fenë e Zotit, duke e deformuar atë e duke futur duart ku nuk duhet në thelb të fesë dhe moralit të saj, e ka dëshmuar veten si krijesë e frikshme; i pabesë, i pamoralshëm, cinik, hipokrit, mashtrues!

Përballë këtij fenomeni, që për ne shqiptarët muslimanë, është mëse i perceptueshëm, edhe nga pozita e jonë

**PËRBALLË KËTJË FENOMENI, QË PËR NE SHQIPTARËT MUSLIMANË,
ËSHTË MËSE I PERCEPTUESHËM, EDHE NGA POZITA E JONË
GJEOGRAFIKE, POR JO VETËM, QËNDRON ISLAMI, FEJA E ZOTIT,
FEJA E LIBRIT TË PANDRYSHUESHËM, E LIBRIT GARANCI
EDHE PËR LIBRAT E TJERË TË DEVIJUAR E TË ZHVATUR,
FEJA E KREJT TË DËRQUARVE, FEJA E SHPRESËS,
ME TË CILËN DO TË ZBRESË NË TOKË ROBI I ZOTIT, ISAI (A.S)
NË KOHËT E MBRAHE, PËR TË PËRHAPUR DRITË E PAQË...**

ajeti kur'anor: “E kush mundet të jetë më mizor se ai që në xhamitë e All-llahut pengon të përmendet emri i Tij (të bëhet ibadet) dhe përpiket për shkatërrimin e tyre.” – (El-Bekare: 114). Ndërsa ajeti i dytë është: “(Përkujto Muhammed) Kur Zoti yt u tha melekëve: “Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një mëkëmbës!” Ata thanë: “A do të vendosësh në të, atë që bëh çrregullime dhe që derdh gjaket, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk dini!” – (El-Bekare: 30).

Dhe mendoj se, sot, njerëzimi sillet rreth këtyre dy realiteteve në marrëdhëniet e tij me fenë, me Zotin, me tjetrin.

TË DASHURIT E MI,

Njeriu pa fé, pa Zot, në liri absolute e pa kufi, e ka humbur busullën, e

gjeografike, por jo vetëm, qëndron Islami, feja e Zotit, feja e Librit të pandryshueshëm, e Librit garanci edhe për Librat e tjerë të devijuar e të zhvatur, feja e krejt të dërguarve, feja e shpresës, me të cilën do të zbresë në tokë rob i Zotit, Isai (a.s) në kohët e mbrame, për të përhapur Dritë e Paqe, pasi kjo botë të jetë mbushur me errësirë e padrejtësi, siç ka nisur të mbushet, fatkeqësisht!

VËLLEZËRIT E MI,

Sot, ne jemi të ftuar ta lexojmë më me qetësi dhe largpamësi pozitën tonë si Njerëz, për të kuptuar se ku qëndrojmë në realitetet e jetës tonë? A jemi ne krijesa, prej të cilës frikësoheshin melekët, apo Mëkëmbësi i Zotit, që ndërton dhe zhvillon jetën e tij, si amanet i shenjtë i Krijuesit?

Ne si muslimanë, jemi të ftuar sot për të kuptuar se nuk mund të jesh

“E mëshiroftë All-llahu

një njeri; zemërmirë kur shet,

zemërmirë kur blen, zemërmirë

kur gjykon, zemërmirë kur

kërkon të drejtën e tij!”

në jetë edhe Mëkëmbës i Zotit, edhe shkelës i Fjalës së Tij!? Nuk mund të jesh edhe Mëkëmbës i Zotit, edhe pranues i të jetuarit nën zgjedhën e injorancës, mashtrimit, korrupsionit, drogës, hashashit, krimin, mungesës së sigurisë, hipokrizisë e parazitizmit në jetë!

Ndërkohë, Resulull-llahu (a.s), teksa vizaton shembullin e përkryer të Mëkëmbësit, ndër të tjera urdhëron: “E mëshiroftë All-llahu një njeri; zemërmirë kur shet, zemërmirë kur blen, zemërmirë kur gjykon, zemërmirë kur kërkon të drejtën e tij!” – (Bukhariu dhe Ibn Maxheh, nga Xhabiri).

Poashtu urdhëron: “Më i miri i njerëzve është ai që më së miri e lexon Kur'anin, edhe ai që më së miri e kupton fenë e All-llahut, edhe ai që më së miri përkushtohet, edhe ai që më së miri urdhëron për mirë, edhe ai që më së miri ndalon të keqen, edhe ai që më së miri i ruan lidhjet farefisnore!” – (Ahmedi, Tabaraniu dhe Bejhekiu, nga Durra bint Ebi Leheb).

Poashtu na tërheq vëmendjen, se: “Më të mirët e ymetit tim janë ata që kur shihen, përmendet All-llahu! Ndërsa, më të këqinjët e ymetit tim janë ata që mbartin fjalë, ata që ndajnë në mesin e të dashurve, dëshiruesit e së keqes për të pafajshmit!” – (Ahmedi, nga Abdurrahman ibn Ganem).

Dhe thotë: “Më të mirët ndër ju janë jetëgjatët vepërmirë!” – (Hakimi, nga Xhabiri).

Ky është modeli ynë, ky është Islami ynë, kjo është e ardhmja e jonë dhe e fëmijëve tanë, të cilët i kemi amanet dhe assesi nuk duhet të tolerojmë të edukohen me shthurjen, imoralitetin, afetarizmin dhe modelet e pashpresa, me të cilat përballet sot rinia e jonë!

(Hytbeja e xhumasë, mbajtur në xhaminë e Parrucës, më 6 janar 2017)

MESAZH URIMI

Hirësisë së Tij, prof. dr. Hasan Kamil Yilmaz

(MYFTI I RI I STAMBOLLIT, TURQI)



Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i dërgoi një mesazh urimi Myftiut të ri të Stambollit, prof. dr. Hasan Kamil Yilmaz, me rastin e marrjes së detyrës së re, në krye të Myftinisë së Stambollit.

Në mesazhin e tij, Myftiu i Shkodrës, ndër të tjera uroi Myftiun e ri të Stambollit: “Nëpërmjet informacioneve zyrtare, mësova për emërimin tuaj në postin e Myftiut të Stambollit. Një lajm i tillë më gëzoi pa masë, aq më tepër duke ju njohur nga afër ju dhe aftësitë tuaja shkencore dhe administrative.

Për këtë, më lejoni që në emrin tim personal dhe të Myftinisë Shkodër, t'ju drejtohem me këtë mesazh urimi, me lutjet më të përzemërta, që All-llahu i Madhëruar t'ju japë mbarrësi dhe sukses në detyrën e re dhe drejtimin e saj! Atij (a.xh) i lutem që të vazhdoni të rrezatoni mirësi, dije dhe urtësi!

Sikurse shpresoj dhe lutem me zemër, që bashkëpunimi i Myftinisë së Stambollit me Myftininë e Shkodrës të ketë rritje dhe zhvillime të reja, në dobi të Thirrjes Islame dhe zhvillimit të saj!”

Myftiu i Shkodrës e ftoi Myftiun e ri të Stambollit për një vizitë zyrtare në qytetin e Shkodrës, të cilin, prof. dr. Hasan Kamil Yilmaz e ka vizituar edhe disa herë të tjera, edhe në detyrën e zv/Kryetarit të Dijanetit të Turqisë.

Shkodër, më 12 dhjetor 2017





Sheikh Muhamed El-Gazali

Shpirtin e kisha të thyer, ndërkohë që po udhëtoja me disa dashamirës drejt Zagrebit për te kampet e refugjatëve të banorëve të Bosnjës dhe Hercegovinës. Isha i mbushur me dhimbje, e nuk kisha nevojë për t'i shtuar më tepër!! Por, patjetër duhej kjo vizitë, në mënyrë që myslimanët atje të ndjenin se pas kanë vëllezërit, që i mbështesin dhe u vjen keq për gjendjen e tyre.

Në fillim të rrugës kaluam në një shesh të madh, në mes kishte një ndërtesë të madhe dhe shoferi tha: Ky është sheshi i xhamisë!

I thashë: Ku është xhamia?

Tha: Ka qenë këtu dhe Titoja ia shembi katër minaret e shndërroi bazën e xhamisë në muzeum, të cilin po e shohim tani!

Ndjeva një ngushticë që po më mbyste! Thashë, ndërkohë që unë po mërmërisja: Titoja, i cili vetes ia atribuoi titullin marrshall, ai është njëri nga udhëheqësit që refuzoi të aderojë mes fuqive të mëdha, dhe duket se goditja e Islamit është prej dukurive të mos aderimit. Sepse unë, sa herë që shfletoj historinë e ndonjërit prej

SHPIRTTHYER...!

Nëse nuk na kthehet vetëdija jonë fetare, atëherë tragjeditë do të përsëriten në vende të tjera. Prandaj, le të zgjohemi, përpara se të jetë vonë!

udhëheqësve të kësaj lëvizje, përveçse shikoj qëndrimin e tij ndaj Islamit, si mos më keq!

Makina jonë çante rrugën e saj, derisa arritëm në kampin e refugjatëve. Turmat e burrave dhe të fëmijëve po na prisnin. Çfarë tu them këtyre njerëzve? Me vete kishim disa ëmbëlsira dhe shumë shpejt i përpinë të uriturit. Mu kujtua ajo çfarë ka ardhur në sunet, ku Aisheja, nëna e besimtarëve i dha një gruas një hurmë, me vete kishte dy vajzat e saj dhe gruaja e ndau hurmën në dy pjesë, e ia dha secilës vajzë nga një gjysmë.

Pashë që disa nëna vepruan kështu e disa të tjera i mundi uria e përpinë atë që morën!! Veshur kishin disa rroba të lehta, aq sa kishin mundur të arratiseshin me to prej shtëpive të tyre. Ata kishin filluar të ndjenin frikë prej dimrit që po vinte, duke ditur se temperaturat atje, nganjëherë shkonin deri në 30 gradë nën zero!

U premtuam se do tu dërgonim batanije për të përballuar të ftohtin.

Ndjeva një urrejtje, që më pushtoi shqisat e mia, ndërkohë që kujtova se Kombet e Bashkuara janë pas gjithë kësaj fatkeqësie. Ato kanë qenë të afta për ta edukuar egërsinë e serbëve, por me qëllim ato nuk e bënë këtë gjë.

A është kjo, i pari veprim i tyre?

Që dyzet e pesë vjet më parë, Az'hari më dërgoi për të jetuar mes refugjatëve

palestinezë në Rripin e Gazës, që aq shumë i ngjante natës së shkuar! Turma të mëdha rënkonin dhe përpara tyre nuk kishin, veçse të ardhme të panjohur. U flisja për një kthim të afërt, por e cila ngjau, me mijëra hebre rusë e nga gjithë vendet e tjera, erdhën për të zënë vendin nëpër shtëpitë e tyre, si përgatitje për të themelimin e Izraelit të madh!

Përse të mos e themi hapur: Kartat e të drejtave të njeriut janë të mbrojtura në çdo vend, përveç aty ku gjenden myslimanët?

Myslimanët vetëm, janë të shporrurit e këtyre organizmave ndërkombëtarë.

Dhe, ajo që të bën të qeshësh në këtë fatkeqësi, është se Këshilli i Sigurimit vendosi të mos furnizojë me armë asnjërin prej palëve, ndërkohë që ai e dinte se serbët trashëguan një ushtri, prej ushtrive më të forta të Evropës dhe se myslimanët kishin qenë punëtorë dhe bujq, duke mos zotëruar gjë për të mbrojtur veten e tyre. Sapo ndodhi lufta, gjymtimet tona mbushnin sheshet, ndërkohë që armiq të tanë nënshkruanin kushtet e tyre!

Nëse nuk na kthehet vetëdija jonë fetare, atëherë tragjeditë do të përsëriten në vende të tjera. Prandaj, le të zgjohemi, përpara se të jetë vonë!

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



Dr. Salahudin Keftaro, Damask

Një jomysliman i afrohet një dijetari mysliman dhe i pëshpërit në vesh, duke i thënë: A është çdo gjë në Kur'anin tuaj e saktë?

Dijetari iu përgjigj: Po, sigurisht!

Ai e pyet: Atëherë, përse Allahu u ka dhënë jobesimtarëve mundësi ndaj besimtarëve, ndërkohë që Ai thotë: "Kurrë nuk do t'i japë Allahu jobesimtarëve mundësi ndaj besimtarëve"!

Dijetari iu përgjigj: Sepse ne jemi myslimanë dhe nuk jemi besimtarë!

Po, cili është ndryshimi mes besimtarëve dhe myslimanëve?

Myslimanët e sotëm i kryejnë të gjitha obligimet e Islamit, me namaz, me zekat, me haxh me agjërim të Ramazanit dhe të tjera adhurime, por ata janë në disfatë të plotë, disfatë në shkencë, në ekonomi, në shoqëri, në ushtri etj.

Përse këto disfata?

Në Kur'an ka ardhur: "Arabët thanë: Kemi besuar! Thuaj: Nuk keni besuar, por thoni: Jemi bërë myslimanë, sepse akoma nuk ka hyrë besimi në zemrat

MYSLIMAN, POR JO BESIMTAR...!

"Të penduarit, adhuresit, falënderuesit, emigruesit, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, urdhëruarit për të mirë, ndaluesit nga të këqijat, ruajtësit e kufijve të Allahut, dhe përgëzoji besimtarët". (Et-Teube: 112)

tuaja!" - (Huxhurat: 14).

Përse ata janë në disfatë? Përgjigjen e ka sqaruar Kur'ani: Sepse myslimanët nuk janë lartësuar në gradën e besimtarëve.

Le të meditojmë në sa vijon:

Sikur të kishin qenë besimtarë të vërtetë, patjetër Allahu do t'i kishte triumfuar, me argument të fjalës së Tij: "Është obligim i Yni triumfi i besimtarëve". - (Er-Rum: 47)

Sikur të kishin qenë besimtarë, do të ishin bërë më me potencë në mesin e kombeve dhe popujve, me argument të fjalës së Tij: "Dhe, mos u dobësoni e mos u hidhëroni, ndërkohë që ju jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë". - (Ali Imran: 139)

Sikur të kishin qenë besimtarë, Allahu nuk do t'i jepte diku tjetër mundësi ndaj tyre, pra s'ndodheshin prej të tjerëve, me argument të fjalës së Tij: "Kurrë nuk do t'i japë Allahu jobesimtarëve mundësi ndaj besimtarëve"! - (En-Nisa: 141)

Sikur të kishin qenë besimtarë, Allahu nuk do t'i kishte lënë në këtë gjendje të ulët, me argument të fjalës së Tij: "Nuk i takon Allahut t'i lërë besimtarët në atë që ju jeni". - (Ali Imran: 179)

Sikur të kishin qenë besimtarë, Allahu do të ishte ta në të gjitha situatat, me argument të fjalës së Tij: "Me të vërtetë Allahu është me besimtarët". - (El-Enfal: 19)

Por, ata kanë qëndruar në nivelin e myslimanëve dhe nuk u lartësuan në shkallën e besimtarëve. Allahu i Madhëruar ka thënë: "Pjesa më e madhe e tyre nuk ishin besimtarë".

Atëherë, kush janë besimtarët?

Përgjigja nga Kur'ani Famëllartë, ata janë:

"Të penduarit, adhuresit, falënderuesit, emigruesit, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, urdhëruarit për të mirë, ndaluesit nga të këqijat, ruajtësit e kufijve të Allahut, dhe përgëzoji besimtarët". - (Et-Teube: 112)

Vëmë re, se Allahu i Madhëruar e ka lidhur çështjen e triumfit, mundësisë, sundimit dhe lartësimi të gjendjes me besimtarët dhe jo me myslimanët. Zëvendësi i Allahut në tokë, ai është besimtari, i cili punon vepra të mira: "I ka premtuar atyre, të cilëve kanë besuar prej jush dhe punojnë vepra të mira, patjetër do t'i bëjë ata zëvendës në tokë..."

A jemi ne besimtarë të vërtetë, ashtu siç dëshiron Allahu, për të merituar triumfin, mundësinë dhe të qenurit zëvendës?

E lus Allahun e Madhëruar të na bëjë ne dhe ju prej besimtarëve të vërtetë.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

**PËRSE TË MOS E THEM I HAPUR:
KARTAT E TË DREJTAVE TË NJERIUT
JANË TË MBROJTURA NË ÇDO VEND,
PËRVEÇ ATY KU GJENDEN MYSLIMANËT?**



**"ARABËT THANË: KEMI BESUAR!
THUAJ: NUK KENI BESUAR, POR THONI: JEMI BËRË MYSLIMANË,
SEPSE AKOMA NUK KA HYRË BESIMI NË ZEMRAT TUAJA!"**

(Huxhurat: 14)



Xhahid Bushati, shkrimtar

Ndonëse libri ka disa kohë që ka dalë në qarkullim, veçanërisht me studiuesit, ai nuk mban distancë apo dita-ditës hapësirë kohore...

Jo, "Minber..." të fton herë pas here, ta shfletosh dhe "të stolisesh" me dijet që përmban libri (i vlefshëm), ta mbushë zemrën me dritë hyjnore. Sigurisht, libra të tillë, me imazhe që të ofrojnë dritshëm dritën, të cilën e kërkojnë koha dhe realiteti bashkëkohor, nuk janë dhe aq të shumtë. Ardhja e tipologjisë së këtij libri pasuron bibliotekën, që përgjithësisht është e varfër. Dhe së fundi, t'i qasësh dijes, që ta ofron libri me bujari, të bën të mendohesh jo pak, të bën ta vështrosh identitetin më mirë,

DIJA, DIJETARI DHE MINBERI, - KY VEND I SHENJTË!


- Gjatë leximit të librit "Minber..." (50 hytbe xhumaje)
të autorit Imam Muhamed B. Sytari -

jetën, familjen, fëmijët, etj. – si një pasuri e vyer, e pazëvendësueshme.

Hytbet që kanë një numër të përcaktuar 50, janë fryte të një pune të dinjitetshme të autorit, të një pune të palodhur drejt mistereve të dijeve, të një "bashkëbisedimeve" me një literaturë të bollshme e Dijetarë që nuk plaken dhe ndriçojnë shekujt. Me këta të fundit, autori Sytari, me arritjet dhe vlerat e këtij libri që përçon, kuvendimi është më shumë se një amanet, devocion dhe 'Thirrje në rrugën Islame'...

Hytbet e paraqitura si punime të këtij libri dhe, që përbëjnë portretin e tij, nuk i ngajnë njëra-tjetrës, ruajnë përbashkësi dhe konfiguracione të veçanta. Ata ruajnë një profil të caktuar. Po "të mundohemi" t'i grupojmë do të shpreheshim kështu: *Hytbe me karakter njohës dhe informues, *Hytbe me trajtesë problemore, *Hytbe me karakter programi dhe strategjie, *Hytbe me përmbajtje aktualiteti, *Hytbe me gjurmë jete, etj.

Po ta vëresh me vëmendje lëndën që



përmbajnë Hytbet, është e pamundur të mos konstatosh disa veçori, të cilat dëshirojmë t'i paraqesim, si: *Problemet shtjellohen saktësisht, *Argumentet janë në funksion të titullit a dukurive që trajtohen, *Ndërtimi i fjalive është i mirëmenduar, kanë qëndrueshmëri dhe falin emocion., *Mesazhet e çdo Hytbeje janë të qarta si drita e diellit dhe përthithen lehtësi nga xhemati, *Stilistikisht kanë ngjyra poetike, *Kanë një strukturë soliditeti e ngjeshje. Përfshihen hallakatjet, *Përgjegjësi në thënien e fjalës. etj.

Për të gjitha këto, Dijetari i armatosur me Dije, gjithëherë e ka të shenjtë Minber-in. Është i sigurt dhe e përligj atë shenjtëri. Elementet e komunikimit flasin për ura ngrohtësie, mësimet jete, porosi e mesazhe, vlerash dhe edukimi. Kjo është dhe arsyeja, mendoj unë që, autori ia ka vënë titullin librit "Minber...". "Minber..." do të thotë përgjegjësi, prijëtar dhe rrezatim.

Hyjnorja dhe realja, mbeten komponentë që Hoxha me diturinë e tij të pandalshme përcjellë e përcjellë dritën e Profetit (a.s.) pa ia da, duke ngrohur zemrat e njerëzve që kanë nevojë për këtë DRITË, që kanë nevojë për BUZËQESHJE...

Këto ishin disa përftesa që mora gjatë leximit të këtij libri të vlefshëm, dituror, siç është "Minber..." i autorit Imam Muhamed B. Sytari.

Shkodër, 23.12.2016

MYFTIU VIZITOI ERUDITIN DHE POLIGLOTIN E SHQUAR SHQIPTAR, H. ISMAIL MUÇEJ

Paraditën e së enjtes, më 26 janar 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga teologët Arben Halluni dhe Lavdrim Hamja, zhvilloi një vizitë në shtëpinë e studiuesit, eruditit, poliglotit dhe përkthyesit të shquar shqiptar, H. Ismail Muçej.

Myftiu u interesua për shëndetin e të nderuarit, H. Ismail Muçej dhe i shprehu atij mirënjohjen e madhe për shembullin e tij, për kontributet e vjera në dobi të dijes, kulturës dhe shpirtit islam, që në rini të tij, gjatë viteve të rënda të burgut në periudhën komuniste, viteve të gjata të punës së rëndë fizike, por edhe pas vitit 1990, kur zotëria e tij ishte kryeredaktori i parë i gazetës "Drita Islame".

Sikurse shkruan edhe z. Islam Dizdari: "Lindi më 14.12.1924 në Shkodër. Jeta e këtij burri është plot kthesa dhe të papritura të mundimshme. Bie e ngrihet, e ka të vështirë, por nuk dorëzohet, nuk thyhet, vazhdon e ecën gjithnjë përpara. Ndoqi studimet në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës ku u shqua si nxënës i shkëlqyeshëm. Që në bankat e shkollës përvetësoi mjaft mirë arabishten, anglishten, frëngjishten dhe italishten. Falë kësaj përgatitjeje iu siguroi bursa për në Institutin Oriental të Napolit. Por kjo nuk u arrit. Shkaqet nuk po i përmendim. Janë politike.

Si medresist mori pjesë në shumë veprimtari atdhetare kundër pushtesit, më vonë u aktivizua në organizatën e Ballit Kombëtar, madje kontribuoi në themelimin e çetave në Pukë e në Kukës dhe kreu detyrën e përkthyesit pranë misionit anglez në veri të Shqipërisë. U lidh dhe bashkëpunoi me nxënës të shumë shkollave të vendeve të huaja, si: Belgjikë, Itali, Turqi, Indi etj., me të cilët shkëmbente literaturë historike, letrare, fetare e shkencore. Iu përkushtua publicistikës duke qenë bashkëpunëtor i rregullt i revistës "Zani i Naltë" "Kultura Islame" dhe "Njeriu". Që krejt i ri, pa i mbushur të njëzetat replikoi plot kompetencë me njërin nga gazetat e njohura shtetërore të asaj kohe (1944) "Bashkimi i Kombit"...

Më 6.11.1952 arrestohet, ku në

fillim dënohet me vdekje që iu kthye në burgim me 20 vjet. Akuzat nuk po i përmendim, ato janë falsifikime të qëllimta të një prokurorie ogurzezë. Këto akuza u përsëritën me qindra herë ndaj burrave të nderuar të kombit tonë, ndaj ajkës së inteligjencës së vendit tonë, ndaj të moshuarve dhe të rinjve. Sundonte injoranca, egërsia, që aq mirë e kemi njohur, sundonte lufta e klasave. Pas viteve sflitëse në punët e rënda të kampeve famëkeqe, tani ndryhet në burgun famëkeq të Burrelit. Këtu zotëri Ismaili kaloi ditët e gjata të pjesës më të bukur të rinisë së tij. Burgu që një shkollë e vërtetë, një vatër me shumë vlera edukimi, burrërie.

Në ato vrima të zeza të birucave të

ndihmën e askujt ai i hartoi dhe më në fund i bëri gati për botim. Por, e them me dhimbje, ato janë ende në dorëshkrim. Ja të japim një panoramë të shpejtë të tyre:

Fjalori Arabisht-Shqip me 45.000 fjalë dhe 20.000 shprehje prej 2.000 faqesh.

Fjalori Shqip-Arabisht me 25.000 fjalë dhe 30.000 shprehje prej 1300 faqesh.

Metodë e mësimi të gjuhës arabe, e përkthyer nga Gaspary Otto Sauer, orientalist i shquar gjerman.

Feja dhe misioni i saj, me 350 faqe.

Pse përqafova Islamin, 120 faqe.

Pohime të një spiuni anglez, 70 faqe.



burgut ku diktatura i kishte ndryrë bijtë më të mirë të popullit për t'i thyer, aty u rritën dhe u edukuan heronj të vërtetë. Sikurse kujton vetë zotëri Ismaili: "... ishte ai mjedis, ajo frymë kulturore e pjekurie që t'i largonte vuajtjet fizike e brengat shpirtërore dhe e mbante njeriun me shpresa se nuk ka mbaruar gjithçka... Aty gjeta mësuesin e fundit të jetës sime, edukatorin e shquar në të gjitha fushat e kulturës që mbeti për mua si edukator dhe dekan i universitetit të jetës. Ky ishte eruditi Et'hem Haxhiademi, nga Elbasani..."

Veprat që shkroi janë shembulli më i qartë se deri ku arrin vullneti dhe këmbëngulja e njeriut, këto vepra as një institut i organizuar nuk do të mund t'i realizonte, e pra i vetëm pa

Rendi i ri botëror, 100 faqe.

Si arriti Kur'ani deri në ditët tona, 70 faqe.

Ka redaktuar një numër të madh librash fetarë, ka botuar me qindra artikuj në organe të ndryshme shtypi brenda e jashtë vendit, ka mbajtur ligjërata në simpoziume e veprimtari të tjera shkencore brenda e jashtë vendit, si në Vjenë, Marok, Libi, Londër, Arabi Saudite etj." - (Artikulli i plotë: <http://www.dritaislame.al/ismail-mucej-simboli-i-vullnetit-.../>)

H. Ismail Muçej, është sot, pa dyshim njëri ndër personalitetet më të shquara të kombit, erudit i palodhur, lexues i rregullt, përkthyes dhe edukator aktiv, përtej moshës së thyer dhe vuajtjeve të panumërta që ka kaluar gjatë jetës.

ISLAMI, DIJA DHE PRODHIMI I SË MIRËS NË JETË...

Shejkh Jusuf El-Karadavi mbetet burim orientues, sidomos kur thotë, se: "Islami synon dijen, që prodhon vepra, jo dijen që prodhon fjalë e debate! Islami dëshiron njohurinë e lidhur me zemrën, që vë në lëvizje vetë zemrën dhe vullnetin!"

Mua më pëlqen ta lexoj në këtë mënyrë marrëdhënien e fesë sime me dijen dhe mundësitë e përhapjes së saj në shoqëri, si alternativë e shëndoshë për individin dhe shoqërinë.

Sikurse mendoj se ka shumë rëndësi të përhapet me të madhe se, Islami mbetet, sot e mot, një alternativë e padiskutueshme që i ofron njeriut nëpërmjet rrugëve të dijes dhe zhvillimit të saj, njohjen e kufijve të vetes dhe sekretin e marrëdhënies së suksesshme me jetën dhe njeriun,

kushdo qoftë tjetri!

Paqja e brendshme, drejtësia e padiskutueshme, modelet e tolerancës logjike dhe dhurimi i mëshirës në çdo detaj të jetës, mbeten veçori të jashtëzakonshme të fesë, me të cilën unë dërguan krejt të Dërguarit e Zotit, deri në Vulën e tyre, Muhamedin (a.s.).

Përndryshe, keqpërdorimi i njohurive dhe i dijeve të pakëta e të cungëta, në drejtim të krijimit të hendeqeve në mesin e poseduesit të tyre dhe komunikuesit, mbetet tregues i varfërisë intelektuale dhe shpirtërore në mirëleximin e Islamit dhe përkthimin e tij në reaksione pozitive në shoqëri.

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, më 31 dhjetor 2016

XHAMIA E KALASË, INTERVISTË E MYFTIUT TË SHKODRËS PËR “GAZETA SHQIPTARE”

Ditën e xhuma, më 13 janar 2017, në “Gazeta Shqiptare” u botua intervista që Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari dha për gazetaren Fatmira Nikolli. Më poshtë, intervista e plotë.

Në një intervistë të botuar dje në “Gazeta Shqiptare”, prof. Aleksander Meksi, argumenton se objekti- Monumenti i Kulturës në Kalanë e Shkodrës, ka qenë së pari kishë dhe më pas është kthyer në xhami, me një dekret të Sulltanit me rënien e Shkodrës, në janar të vitit 1479.

Ai propozon që objekti të bëhet muze për kalanë pasi t’i nënshtrohet një restaurimi. A jeni ju dakord që të kthehet në muze?

“Myftinia Shkodër e ka thënë fjalën e saj në lidhje me rrënojat e Xhamisë shekullore të Sulltan Mehmet Fatihut në kalanë e Shkodrës. Në shumë kala të vendit ekzistojnë xhami të tilla, si rasti i asaj në kalanë e Prezës, që u inaugurua vitin 2015, edhe me praninë e presidentit të Turqisë, z. Taip Rexhep Erdogan, falë investimit të organizatës qeveritare turke, TIKA.

Një bashkëpunim i shtetit shqiptar me atë turk në këtë drejtim, do të ishte mëse i duhur dhe me dobi. Edhe pse, mendoj se restaurimi i xhamisë shekullore të kalasë së Shkodrës mund të bëhet edhe me financime të vetë qeverisë shqiptare, pasi ajo mbetet një gjurmë e rëndësishme e trashëgimisë sonë shpirtërore kombëtare.”

-A do ishte me vend që të merrej shembull-Bazilika e Shën Sofisë në Stamboll, që pasi u bë Xhami nga Sulltan Mehmeti për një kohë të gjatë, sot shërben si muze?

“Turqia dhe Shqipëria janë dy realitete të ndryshme, që bashkohen në shumë pika dhe ndahen në shumë të tjera. Është e vërtetë se Xhamia e Aya Sofisë është një muze i bukur, që dëshmon mbi të gjitha madhështinë e tolerancës islame, të trashëguar ndër shekuj nga muslimanët e krejt botës dhe e spikatur në ditët e Hilafetit Osman.”

-A lidhet edhe historia e këtij objekti me historinë e vetë Shqipërisë dhe të vetë feve, ku në fillim erdhi Krishtërimi e më pas Islami?

“Krishtërimi dhe Islami janë dy fetë kryesore të shqiptarëve, ku secila prej tyre ka ndërtuar vlera dhe mirësi, që rrezatohen shumë mirë edhe në marrëdhëniet e mrekullueshme ndërfaqetare në mesin e qytetarëve të vendit tonë, sot e mot.

Ndërkohë, xhamia shekullore e kalasë

Myftiu i Shkodrës: Është xhami, jo kishë, nuk bëhet muze si Aya Sofia e Stambollit

Fatmira Nikolli



Imam Muhamed B. Sytari: Të bëhet si me xhaminë e Prezës, që u përrua nga Erdogan

Nuk mund ta bëjmë muze xhaminë në kalanë e Shkodrës, siç ishte bërë në Stamboll me Aya Sofinë. Turqia dhe Shqipëria janë dy realitete të ndryshme, që bashkohen në shumë pika dhe ndahen në shumë të tjera. Është e vërtetë se Xhamia e Aya Sofisë është një muze i bukur, që dëshmon mbi të gjitha madhështinë e tolerancës islame, të trashëguar ndër shekuj nga muslimanët e krejt botës dhe e spikatur në ditët e Hilafetit Osman.

së Shkodrës, mendoj se hyn në atë pjesë, për të cilën shkruan edhe Hamdi Bushati, kur thotë, se: “a ishte kjo xhami ma parë kishë nuk dihet me siguri se nuk ka ndonjë dokument real që ta vërtetojë...”¹

-Prej vitesh, komuniteti i krishterë dhe ai mysliman në Shkodër, kanë debatuar në distancë, për objektin, pasi të dyja palët e pretendoni. A jeni ulur të bisedoni dy komunitetet, për gjetjen e zgjidhjes? Cila është zgjidhja që ju propozoni?

“Kemi biseduar disa herë në lidhje me këtë temë me drejtuesit më të lartë të Kishës Katolike dhe asaj Ortodokse në Shkodër. Myftinia Shkodër e konsideron veprimin e Kishës Katolike si një provokim të panevojshëm, që prek kufijtë e harmonisë ndërfaqetare dhe krijon reagime të panevojshme në mesin e besimtarëve dhe qytetarëve të Shkodrës. Këtë shqetësim dhe reagimin tonë mospranues të këtij veprimi ia kemi komunikuar edhe zyrtarisht, si Arqipeshkvisë Shkodër-Pult, si Ministrisë së Kulturës, si Bashkisë Shkodër etj.

Zgjidhja është e qartë: Xhamia shekullore e kalasë së Shkodrës, është një objekt adhurimi, që i përket atij komunitet, që për shumë shekuj e ka shfrytëzuar legjitimisht dhe, të cilin, pavarësimi i vendit e gjet xhami, pavarësisht faktit shumë me rëndësi, se qyteti ishte zhvendosur nga kalaja dhe zona përreth dhe, natyrisht ajo xhami

1. Hamdi Bushati, vepra: “Shkodra dhe motet”, botimi i dytë i rishikuar, Shkodër, 2005, vëll. I, f. 163.

kishte dalë thaujse krejtësisht jashtë funksionit praktik!”

- Në intervistën tuaj për “TRT” shqip, ju shpreheni se objekti është xhami dhe se nuk keni të dhëna që ka qenë kishë. Meqë ka studiues që pretendojnë se objekti ka shërbyer edhe si kishë, edhe si xhami, a do të ishte e pëlqyeshme, që edhe komuniteti mysliman edhe ai katolik, të kryente shërbesa fetare në këtë objekt, secili komunitet me rastet e festave të veta?

“Muslimanët falen në xhami, të krishterët (këtu, katolikët) në kisha. Emërtimi kishë-xhami i një objekti adhurimi është krejtësisht qesharak dhe abuzues. Nuk ka asnjë lidhje me temën e harmonisë ndërfaqetare.

Sot, falë Zotit ne shqiptarët e krejt besimeve jetojmë në një hapësirë kohore, kur secili komunitet ka objektet e veta të adhurimit; diku ka xhami e diku kisha, diku ka teqe e diku tjetër manastire, që secila prej tyre kryen një funksion të caktuar, bazuar mbi një logjikë fetare dhe identitare. Ky diversitet, është një vlerë e bukur në mozaikun e vlerave tona kombëtare, që duhet mirëmbajtur dhe ruajtur me shumë kujdes e fanatizëm legjitim.

Xhamia shekullore e kalasë së Shkodrës, është pa dyshim një vend-adhurimi i lashtë, që dëshmon më së miri detaje të një historie fetare dhe rrethanave të saj.”

“KY YMMET RINGRIHET MBI KUJTESËN E SË SHKUARËS!”...



Është e pamundur ta vizitosh e të mos tërhiqesh pas këtij vendi të paqte, edhe pa e njohur në thellësi dhe detaje historinë e tij...

Ka një frymë të padukshme, krejtësisht transparente, që të përshkon qenien, teksa shkel mbi këtë tokë...

Hapësira e madhe e saj, pozita gjeografike, mali, deti, terreni thaujse malor, gjelbërimi me shumëllojshmërinë e florës, e shumë detaje të tjera të ngulitura në memorie, e bëjnë të lakmueshme për t’u vizituar sërish, edhe pse je larguar prej saj...

Emri i kësaj toke, është emër i madh. Peshon rëndë dhe, madje, nuk ka të peshuar.

Në vetvete, ky emër mbart në vetvete një histori të madhe lavdie, sakrificash sublime, vetëmohimi e shtrëngim duarsh të shumta për një qëllim të shtrenjtë..., një qëllim që u kthye në histori mrekullie, me bekimet dhe përkujdesjen hyjnore të Zotit të gjithësisë...

Sot, u ula në gjunjë mbi këtë tokë të begatë! Ndjeva një emocion të madh, teksa prekja një nga simbolet e saj, mbi



të cilin ishte shkruar emri i Shkodërloces së shtrenjtë, që i fali ymmetit, në ditët e tij më të vështira dhe vendimtare, djemtë e saj më të mirë, në mbrojtje të dinjitetit, krenarisë, historisë së shekujve plot dritë teuhidi, paqeje, sigurie e drejtësie..!

Sot, u ndjeva krenar dhe i fortë, teksa lexoja emrat e nderuar të shëhidëve të panumërt, nga Shkodra, Elbasani, Dibra, Mitrovica, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Tetova e, sa e sa qytete shqiptare e nga mbarë trojet e ymmetit...

Sot, nga kjo tokë përhapej kudo drita e pashuar e lavdisë së martirëve të dinjitetit e krenarisë legjitime të këtij besimi, kësaj feje e këtij humanizmi të bekuar islam!

Sot, mesazhet që përhapeshin gjithandej në hapësirat e Çanakalesë, rrezatonin shpresë ripërtëritjeje, rizgjimi e rimëkëmbjeje të një ymmeti, që Zoti e zgjodhi të jetë “Dëshmitar i Njerëzimit”... Sikur thonin: “Ky ymmet ringrihet mbi kujtesën e së shkuarës!”...

Imam Muhamed B. Sytari

Çanakale, më 18 dhjetor 2016



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Pjesa

më e pëlqyer

e besimit

është durimi

dhe toleranca!"

(Dejlemiu, nga Akil ibn Jesar, si dhe Bukhariu në "Et-Tarikh", nga Umejir El-Lejthi)

XHAMIA E SULTAN MEHMET FATIHUT KALASË SË SHKODRËS, PJESË E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E MUSLIMANËVË SHQIPTARË!...

(Intervistë ekskluzive me Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed Sytari për TRT-në, Zërin e Turqisë në Shqip)

Si kalon murin e dytë të kalasë “Rozafat”, në një hapësirë në qendër të saj, bri varrezave që shtriheshin deri te muri e tretë, ku ka qenë një derë hekuri, ngrihej një xhami. Evlija Çelebiu, në veprën e tij, atë e quan “Xhamia e Sulltan Muhamedit”. Data e ndërtimit nuk i dihet, veçse vlerësohet si ndër më të hershmet. Këtë tezë e mbështet fakti se ajo është ndërtuar në një periudhë me xhamitë e Hynqarit e të Selvisë (në vitin 1478) dhe me xhaminë e lagjes Alibegaj (para vitit 1529). Një tjetër version i mundshëm është edhe ai se ku zinte vend ushtria turke, ndërtonte xhami që ushtarë e oficerë të kryenin ritet fetare, kështu që nuk përjashtohet edhe ndërtimi i saj pas vendosjes së ushtrisë turke në kalanë Shkodrës në vitin 1478.

Ndërtesa e xhamisë kishte një kullë guri deri në 1 metër mbi çati, pastaj vazhdonte minareje prej dërrase që është ndërtuar së bashku me restaurimin e xhamisë gjatë sundimit osman në vitin 1479. Vendi ku faleshin besimtarët, ka pasur në njërën anë tri dritare me hark dhe derën e hyrjes në anësore. Çatia e mbuluar me tjegulla, ka patur një kulm.

At Eresmo Belneo, në vitin 1757 për këtë xhami thotë se ajo ka qënë “xhami e madhe, e bukur...”.

Një tjetër dëshmi të saj, kemi vizatimin e një autori gjerman, i cili e ka bërë atë mbi bazën e tregimit të një udhëtari që e kishte vizituar Shqipërinë në vitin 1820.

Si objekt kulti brenda territorit të Kalasë së Shkodrës, ajo ka qenë mbajtur vazhdimisht në gjendje të mirë. Riparohej shpesh nën kujdesin e pashallarëve dhe më vonë edhe nga guvernatori turk. Në këtë xhami kryente ritet paria, oborrtarët, familjet e tyre, oficerët e ushtarët. Këtu janë kënduar Mevlude në çdo vit me një pjesëmarrje edhe nga qyteti poshtë kalasë.

Haxhi Mustaf Boriçi, në ditarin e tij ka shkruar se: “Në këtë xhami ka dëgjuar vase dhe ka marrë pjesë në këndimin e Mevludeve”. Ai madje shënon edhe datën 4 mars 1846, ditën e hënë, kur në këtë xhami ishte kënduar Mevludi.

Ka të dhëna se ritet fetare në këtë xhami të jenë kryer deri në vitin 1865, ndërsa si pronë-vakëf e bashkësisë islame e Shqipërisë ka qëndruar deri në vitin 1967, vit që shteti monist mbylli të gjitha



kultet fetare dhe ndaloi me ligj besimin dhe praktikimin e fesë.

Një përshkrim dinjitoz të kësaj xhamie jep studiuesi i njohur shkodran Hamdi Bushati në librin voluminoz “Shkodra dhe motet” si dhe revista “Leka”.

- Por cila është situata e sotme e këtij kulti të rëndësishëm fetar dhe çfarë rëndësie mbart ajo për besimtarët myslimanë të Shkodrës, por jo vetëm?!...

Për këtë myftiu i zonës Shkodër, imam Muhamed Sytari në një intervistë ekskluzive për TRT, Zërin e Turqisë në Shqip shprehet:

... Do të thoja fillimisht se për çdo popull, për çdo komunitet, për çdo bashkësi besimtare, objektet e kultit janë simbolika të shtrenjta dhe të shenjta, të cilat në një mënyrë apo tjetër ruajnë në heshtjen e tyre vetëdijen fetare të cilitdo prej komuniteteve që i respekton, i nderon dhe i ruan me fanatizëm legjitim këto objekte.

Duke iu referuar shkrimeve të vjetra, “fortesa e Shkodrës ngrihet mbi një shkëmb të lartë e të rreptë, pranë liqenit të madh të Bunës”, sikurse shkruan Evlija Çelebiu në “Seyahatnamen” e tij. Në këtë fortesë, thotë ai, ka pak shtëpi dhe një xhami, ajo e Sulltan Muhamedit, pra e Sulltan Fatihit, e cila është e mbuluar me tjegulla dhe e ndërtuar sipas stilit të vjetër. Normalisht këto shkrime të Evlija Çelebiut në “Seyahatnamen” e tij janë regjistruar diku në vitet 1070-1080 sipas kalendarit hixhri, përkatësisht rreth viteve 1660-1670 sipas erës sonë.

Normalisht, ajo që vlen të theksohet, kur bëhet fjalë për xhaminë e Sulltan Mehmet Fatihut është edhe shënimi i Hamdi Bushatit, i cili në veprën e tij “Shkodra dhe motet” thekson se: “Osmanlinjtë përsa i përket kthimit të

kishave në xhami ndiqnin këtë parim: Me lanë kisha aq sa i mjaftonte popullit për me kry funksionet fetare, të tjerat me i kthy në xhami”. Këtë e them nëse realisht xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut ka pasur një origjinë kishtarë, sepse Hamdi Bushati duke iu referuar dokumentave të vjetra dhe hulumtimeve të tij shkruan se: “kleri katolik pretendon se ky objekt ka qënë kishë, duke u bazu në relacionet e Pjetër Bogdanit të vitit 1685”, por ai thekson gjithashtu se: “a ishte kjo xhami më parë kishë nuk dihet me siguri se nuk ka asnjë dokument real që ta vertetojë atë”. Njëkohësisht ai thotë se: “kleri katolik tu pretendue se ajo ka qënë kisha e Shën Shtjefnit ose e Sh’ Kollit në kohën e pushtimit Fashist, tu dashtë me përfitue nga situata e favorshme klerikale planifikoi rindërtimin e saj, kështu që me kohë edhe kështjella “Rozafat” do të kthehej në një institucion fetar apo kuvendesh etj.”

Natyrshëm unë nuk do të analizoq thëniet e njërit apo tjetrit prej kronikanëve të kohëve të shkuara, por ajo që dua të them me përgjegjësinë më të madhe dhe bazuar në fakte konkrete historike është se objekti i kultit në kalanë e Shkodrës është xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut, i cili për ne myslimanët mbetet një personalitet i shquar i historisë së pastër, të shtrenjtë e të shenjtë të shekujve të kaluar.

Sulltan Mehmet Fatihu është personi të cilin e ka paralajmëruar ardhjen e tij, triumfin e tij, lavdinë e tij dhe madhështinë e tij vetë Profeti i Islamit, Hz. Muhammedi (a.s), i cili thoshte për çliruesin e Kostandinopojës: “Niemel emiru, emiruha”, pra: “Bekuar qoftë komandanti i asaj ushtrie, bekuar qofshin ushtarët e asaj ushtrie!”

Tek ne myslimanët, Sulltan Mehmet

Fatihu është personalitet i shtrenjtë dhe është një ndër udhëheqësit më të shquar të historisë së njerëzimit. Ne e respektojmë dhe e nderojmë atë, sepse është pjesë e historisë sonë. Kur themi “Historia osmane”, do të thotë historia e krejt myslimanëve të botës, përfshi edhe myslimanët e Shqipërisë. Kësisoj ne e respektojmë, e nderojmë dhe e vlerësojmë mbetjen e xhamisë që mbanë emrin e tij në kalanë e Shkodrës, maksimalisht si një relikte e çmuar dhe e shquar e historisë sonë fetare dhe asaj kombëtare.

- Kisha katolike duke pretenduar se ky kult fetar para se të jetë xhami 500 vjeçare ka qene e krishtere, ajo për 12 vite radhazi kremton meshë vjetore, për çdo 26 dhjetor, në përkujtim siç e quajnë ata të pajtorit të Shkodrës, shën Shtjefni, gjë e cila ka sjellur edhe reagimin e myftinisë, e cila e konsideruar një provokim dhe cënim të kufijve të harmonisë dhe torelancës ndërjetare, jo vetëm nga arqipeshkvia, por edhe nga ministria e kulturës e Shqipërisë.

... Myftinia e Shkodrës në momentin e parë, kur është vënë në dijeni me veprimin e kishës katolike të Shkodrës për zhvillimin e një meshe të papritur në xhaminë e Sulltan Mehmet Fatihut në kalanë e Shkodrës, ka bërë kontaktet e duhura dhe ka komunikuar në mënyra të ndryshme legjitime zyrtare.

Me drejtuesit e kishës katolike janë marrë takime të ndryshme, është komunikuar nëpërmjet shkresave, takimeve, bashkëbisedimeve të ndryshme, ku është kërkuar nga myftilerët e ndryshëm të kësaj periudhe rreth 12-13 vjeçare që të ndalohej ky veprim, i cili për ne myslimanët e Shkodrës e për myftininë konsiderohet si një provokim i pakuptimtë dhe i pa nevojshëm, i cili prek në thelb vlerat e harmonisë ndërjetare në qytetin e Shkodrës, këtë harmoni dhe mirësi të madhe që e kemi mëkuar me mësimet e Kur’anit, me mësimet e Hz. Muhammedit (a.s) dhe mësimet e traditat më të mira të historisë sonë islame ndër shekuj, përfshirë edhe pjesën e fundit të Hilafetit Islam, atij Osman.

Normalisht, ne si myftini e Shkodrës kemi reaguar edhe ndaj ministrisë së kulturës që ka dhënë lejen për realizimin e kësaj ceremonie fetare. Në thelb, ne nuk ndërhijmë ne aktivitetin fetar të asnjë komuniteti fetar në vendin tonë. Respektojmë të gjitha komunitetet, vlerësojmë aktivitetin legjitim të gjithsecilit prej komuniteteve fetare, si një e drejtë legjitime në një shtet dhe në një vend ku besimet dhe komunitetet fetare kanë të drejtat e tyre të barabarta.

Por, nuk e kuptojmë faktin pse

ministria e kulturës që sot mban në inventarët e saj mbetjet e xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut, (që në fakt është një vakëf i shenjtë dhe duhet të ishte në administrim të komunitetit mysliman të Shqipërisë), përse ministria ka dhënë leje për realizimin e kësaj ceremonie fetare?!

Realisht ne e kemi kundërshtuar këtë veprim, i kemi komunikuar me shkresa, ministrinë e kulturës, kishën katolike, institucionet e tjera të qytetit të Shkodrës, komunitetin e kulteve etj, sikurse kemi vënë në dijeni normalisht edhe komunitetin mysliman të Shqipërisë.

E vërteta është së me 26 dhjetor të vitit që shkoj, pra para pak ditësh, pas vizitës së krishtlindjes që bëmë në kishën katolike, ditën e nesërme u befasuam me faktin që drejtues të kishës katolike, të cilëve u uruam një ditë më përpara festën, ishin tashmë në xhaminë tonë historike të shtrenjtë e të shenjtë, duke kremtuar një meshë.

Për mua personalisht ky është një veprim krejt i pakuptimtë, ashtu edhe për myftininë e Shkodrës dhe për komunitetin e bashkësinë e myslimanëve të Shkodrës.

Ky është një provokim i panevojshëm dhe një cënim i bashkëjetesës dhe harmonisë ndërjetare, të cilën e kemi për detyrë ta ruajmë, ta mbrojmë dhe ta mëkojmë me vlerat më të mira të respektit të ndërsjelltë dhe mos cënimit të simboleve të shenjta historike përkatëse.

-I pyetur për ndonjë kontakt me ambasadën e Republikës së Turqisë në Tiranë për të pasur edhe ajo rolin e saj në ruajtjen e kësaj trashëgimie islame dhe njëkohësisht pjesë e kulturës osmane, myftiu imam Muhamed Sytari tha:

... Fillimisht do të thoja se objekti i xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut në kalanë e Shkodrës është pjesë e pandarë e kulturës dhe e trashëgimisë islame të vendit tonë, pra pjesë e trashëgimisë islame shqiptare.

Unë besoj se së pari është detyrë e shtetit shqiptar, e ministrisë së kulturës që të merret me restaurimin e kësaj xhamie të vjetër shekullore, e cila përkthen më së miri shpirtin dhe identitetin islam të komunitetit më të madh fetar në Shkodër, pra komunitetit mysliman.

Mendimi im është që fillimisht është detyrë e institucioneve tona shtetërore që të merren me restaurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e këtij objekti, pra xhamisë së kalasë, por njëkohësisht meqenëse ky objekt lidhet edhe me emrin e madh të Sulltan Mehmet Fatihut çdo bashkëpunim me ambasadën turke, me shtetin turk dhe me agjencinë TIKa do të ishte mëse i dobishëm, për arsye se ata kanë eksperiencë shumë më të madhe dhe

kanë mundësi shumë më të mëdha se sa shteti ynë, ministria e jonë e kulturës si dhe instituti i monumenteve të kulturës për restaurimin dhe kthimin në identitet të kësaj xhamie shekullore.

- Por, çfarë zgjidhjeje ofron myftinia Shkodër për këtë provokim që i bëhet herë pas here këtij kulti fetar?

... Është e nevojshme që të përsëritet, të thuhet dhe të lajmërohet më të madhe se objekti i kultit në kalanë e Shkodrës është xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut! Nuk ka nevojë për asnjë etiketim tjetër dhe nuk ka nevojë për asnjë cilësim tjetër shpesh herë edhe qesharak që i bëhet këtij objekti për qëllime krejt të panevojshme që shpeshherë kthehen në objekte provokimi ndaj historisë sonë, ndaj identitetit tonë islam dhe ndaj gjurmëve të trashëgimisë tonë historike, kombëtare dhe kulturore.

Ndërsa për sa i përket zgjidhjes më të mirë, ajo është që çdo institucion shtetëror apo fetar të respektojë veten fillimisht, të respektojë tjetrin dhe të punojë maksimalisht për ndërtimin e urave të komunikimit dhe jo duke ndjekur rrugët e provokimeve të panevojshme, të cilat çenojnë një ndër veçoritë më të shenjta dhe më të shtrenjta të popullit shqiptar që është harmonia ndërjetare.

Për asnjë arsye dhe shkak në botë askujt nuk i falet dhe as nuk i tolerohet që të prekë thelbin e harmonisë ndërjetare dhe të shkaktojë provokime të panevojshme, duke shkaktuar njëkohësisht plasaritje krejtësisht të pafalshme dhe të patolerueshme në thelbin e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërjetare, për të cilën shquhemi si popull dhe komb, falë mësimave dhe udhëzimeve të Librave të Shenjtë, që mundohemi t’i pasojmë dhe zbatojmë ditë për ditë në jetën dhe në marrëdhëniet tona komunitare.

- Në fund myftiu Sytari lutet që kjo xhami të vizitohet nga të gjithë besimtarët dhe jo vetëm:

Unë lutem me zemër që të mos jetë e largët dite që xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut të kthehet në identitetin e saj dhe të vizitohet nga të gjithë besimtarët, nga jobesimtarët, nga jomyslimanët, nga të krishterët dhe, pse jo, të pozojmë së bashku myslimanë dhe të krishterë në ambientet e kësaj xhamie shekullore që i hapë dyert dhe krahët e saj për çdo njeri që ka një vullnet të mirë, një qëllim të mirë, që beson në një Zot dhe thërret drejt harmonisë së besimit dhe harmonisë së vlerave të tij.

Përgatiti për TRT Shqip,
Arben Halluni, Shqipëri

INTERVISTË E MYFTIUT TË SHKODRËS, IMAM MUHAMED SYTARI PËR “STAR PLUS TV”

Ditën e hënë, më 23 janar 2017, Imam Muhamed Sytari ishte i ftuar në emisionin “Studio e Hapur” të gazetarit Ergys Kavaja, për të folur rreth ngjarjeve aktuale. Më poshtë intervista e plotë:

Ergys Kavaja: Po e lidhin Shkodrën me ISIS-in, nisur edhe nga rasti i fundit; a po cenohet imazhi i myslimanëve në kryeqendrën e veriut?

Myftiu: Është një pyetje interesante dhe aktuale në raport me shumë ngjarje që po zhvillohen me një dinamikë shumë të shpejtë në qytetin tonë, në një hark kohor prej pak muajsh, ku u bëmë dëshmitarë të disa ndodhive dhe shfaqjeve, për të cilat ne nuk ishim mësuar më parë t'i shihnim dhe të ishim dëshmitarë se si u servirën, dhe në këtë formë se si u prezantuan për masat e gjera të besimtarëve dhe qytetarëve të Shkodrës e të mbarë Shqipërisë.

Unë mendoj se lajme të tilla nuk i bëjnë mirë harmonisë kombëtare dhe, mbi të gjitha, vetë imazhit të Shqipërisë, sepse përherë ne kemi për detyrë që ta ruajmë imazhin e vendit tonë dhe ta prezantojmë me dinjitet si një vend, i cili prodhon vlera, pavarësisht se realitetet e Shqipërisë përpëliten në kurba të çuditshme.

Ne flasim për vlera, për elitarizma, por nuk mund të mohojmë në të njëjtën kohë mjerimin, skamjen, varfërinë, përhapjen në masë të fenomeneve të dëmshme që dëmtojnë moralin e rinisë, moralin e familjes. Në fakt, këto janë shfaqje ekstreme, për të cilat të gjithë duhet të bashkëpunojmë për t'i luftuar dhe për ta mbrojtur vendin tonë prej tyre.

Në gjithë këtë realitet të dhimbshëm, shfaqja e këtyre fenomeneve që lidhen me terrorizmin apo me elementë të ekstremizmit, me ngjyresë fetare në rrafsh global në vendin tonë, natyrisht që janë lajme që nuk na bëjnë mirë, përkundrazi, na alarmojnë.

Ka një propagandë shumë të madhe dhe sikur ka një forcë të fshehtë që do me çdo kusht të krijojë alibi false se në Shqipëri ka rrezik nga forma të ndryshme të terrorizmit, apo që lidhen me organizata terroriste botërore, të cilat i kemi dënuar përherë dhe ndaj të cilave ne si myslimanë shqiptarë jemi të distancuar në çdo moment, dhe për këtë dëshmojnë predikimet e ndryshme.

Ajo që më shqetëson është lidhja e këtyre fenomeneve dhe propagandave



aspak dashmire me Shqipërinë dhe Shkodrën në veçanti dhe me komunitetin mysliman apo bashkësinë e myslimanëve, me islamit dhe me fenë tonë. Në thelb, islami është diçka dhe terrori e dhuna është diçka krejt tjetër. Nuk mund të ketë një logjikë që vendos paralele ndërmjet islamit dhe terrorizmit.

Shkodra ishte e para që hapi xhamitë dhe kishat pas regjimit komunist; në 1997-ën, komunitetet fetare dolën në rrugë për të mbajtur të bashkuar popullin. Është një simbol harmonia fetare.

E.K: Pse po lidhet Shkodra me ISIS-in, këtë organizatë terroriste në një kohë që ky qytet nuk është i lidhur drejtpërdrejt me ISIS-in?

Myftiu: Shpresoj të jetë kështu, dhe lutem që të jetë kështu në vazhdimësi, jo vetëm në raport me këtë hibrid të laboratorëve të së keqes, por edhe me çdo hibrid tjetër, me çdo krijesë tjetër të së keqes që del herë pas here në skenë për të mbajtur peng komunitete të tëra njerëzish.

Ajo që dua të them me të madhe është se, ne vazhdojmë të lutemi dhe të punojmë ditë pas dite që këto propaganda dhe hijet e zeza të tyre të qëndrojnë sa më larg komunitetit tonë, kombit tonë, sepse e kemi për detyrë dhe dashje pa dashje krejt bota është e përfshirë në këtë luftë, në këtë shqetësim të madh, i cili nuk ka besë, i cili nuk ka moral, nuk ka ekuilibër, dhe lutemi që Zoti të mbrojë njerëzimin nga kthetrat e së keqes. Bota islame përballet me një luftë të madhe, shumëngjyrëshe në shumë drejtime;

përmendim Sirinë, Irakun, Palestinën, që janë djepe të qytetërimeve botërore.

Ajo që dëshmohej sot në këto vende dhe që lidhet drejtpërdrejt me interesat e krejt vendeve ku ka myslimanë, është një dhimbje e madhe dhe një përpjekje e madhe për të shkatërruar çdo gjë që lidhet me të shenjtën, që lidhet me shekujt, që lidhet me civilizimet, qytetërimet, dhe për këtë i lutemi Zotit që të ketë mëshirë për njerëzit e për botën, sepse noton në ujëra të turbullta dhe në një mungesë sigurie, atmosferë lufte gjithandej.

E.K: E ka shqetësuar Myftininë e Shkodrës videoja e mësueses Emine Alushi që u shfaq në emisionin “Stop”?

Myftiu: Njerëzit kanë nevojë për një lloj imuniteti që i bën të mos reagojnë në këtë mënyrë si u dëshmuara gjatë këtyre ditëve nga raste si ky i zonjës në fjalë. Një zhurmë e madhe, një zhargon i padenjë për qytetarë të ndershëm e të moralshëm të Shkodrës, por jo vetëm, etiketime nga më të çuditshmet. Sikur ka një forcë të fshehtë në këtë vend që do me çdo kusht me nxjerrë të keqen nga çdo gjë.

Ishte një rast, për të cilin kanë deklaruar institucionet përkatëse dhe nuk është Myftinia e Shkodrës ajo që duhet të deklarojë apo të thotë diçka në lidhje me këtë çështje, por gjithsesi, meqenëse lidhet me Medresenë dhe Medreseja është varg i institucioneve që lidhen me aktivitetin e Myftinisë së Shkodrës dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, dhe nga posti i myftiut të Shkodrës dhe që e nje nga afër zonjën në fjalë, dhe po them motrën time më mirë.

Unë po them se, në Medresenë e Shkodrës të gjithë mësuesit dhe mësueset bëhen pjesë e stafit pas një filtrimi shumë serioz dhe shumë korrekt, të cilin e ka kaluar edhe motra jonë Eminia, e cila karakterizohet nga një moral i naltë dhe nga një frymë e naltë qytetare. Normalisht që e kam dëgjuar atë regjistrim të cungët, me të cilin unë nuk pajtohem, sepse nuk jam pajtuar në thelb asnjëherë me idenë e asaj përmbajtjeje, jo vetëm nga goja e saj, por nga kushdo tjetër, por, sikurse e dëshmojnë edhe togat e zeza të Shkodrës, ndalimi i saj ka qenë krejt i pakuptimtë dhe i paligjshëm.

Unë shpresoj dhe lutem që shumë shpejt të zbardhet kjo çështje dhe ajo t'i kthehet normalitetit të saj, sepse është një nënë fëmijësh, është një zonjë e nderuar dhe është një bashkëshorte plot dinjitet, e cila nuk ia ka për borxh askujt këtë lloj persekutimi të paqytetëruar, të papranueshëm dhe psikologjik që rëndon mbi të për shkak të një deklarate apo të një incizimi për të cilin të gjitha institucionet serioze kanë thënë fjalën e tyre në mënyrën më të qytetëruar dhe më korrekte. Kësisoj, rasti në fjalë nuk ka asnjë lloj lidhjeje, as me organizata terroriste, as me propaganda terroriste, as me rekrutime terroriste.

E.K: Në nëntor të vitit të kaluar, në prag të ndeshjes së Shqipërisë me Izraelin, sërish ishte Shkodra në qendër të vëmendjes, pas disa arrestimeve dhe shoqërimeve nga policia të besimtarëve myslimanë. A ka një lloj hatërmbetjeje ndaj kësaj situatë nga besimtarët myslimanë?

Myftiu: Sigurisht që ka një irritim të arsyetuar, të justifikuar të besimtarëve dhe qytetarëve të Shkodrës. Shkodra nuk ia kujt për borxh këtë lloj propagande.

E kam kundërshtuar me të madhe dhe e kam bërë publike edhe në deklarata të tjera mënyrën se si është servirur lajmi i kësaj ndodhie dhe lidhjet krejtësisht të gabuara të detajeve të këtij lajmi, lidhja e tij me emrin e islamit, me emrin e myslimanëve, në raport me një meshë që ishte atë ditë, një ngjarje shumë e rëndësishme për komunitetin katolik. Normalisht që, këtë nuk e kam pranuar dhe nuk mund ta pranoja që myslimanët të vendosen në një vend ku nuk e meritojnë dhe në raport me bashkëqytetarët e tyre dhe vëllezërit shqiptarë të një besimi tjetër.

E.K: Dikur kemi pasur frikë nga agjenturat e huaja; a duhet të kemi sërish frikë nga të tretë që mund të tentojnë të prishin harmoninë ndërfetare në Shqipëri dhe në Shkodër?

Myftiu: Vlerat gjithmonë janë të rrezikuara nga antivlerat dhe mirësia e madhe e kësaj pasurie kombëtare, që është bashkëjetesa ndërfetare apo harmonia ndërfetare në mesin e qytetarëve, por edhe të komuniteteve, është një vlerë që duhet përkujdesur ndaj saj, dhe shteti në veçanti duhet të tregojë kujdes shumë të madh për ruajtjen e kësaj atmosfere dhe krijimin e një klime edhe më të mirë në favor të komuniteteve fetare për të praktikuar frymën e tyre dhe për të përhapur mirësinë e tyre.

Mendoj se shteti ka një përgjegjësi shumë të madhe për të mos lejuar që pikërisht kjo vlerë dhe kjo mirësi të cenohet qoftë edhe me veprime ndoshta të pamatuna ose ndoshta veprime edhe të dhura, por të përkthyer në mënyrë të gabuar.

E.K: E keni thënë shpeshherë se myslimanët nuk mund të barazohen as me terrorizmin, por as me ngjarje të turpshme që shpesh ua kanë faturuar myslimanëve. Cili është mesazhi juaj?

Myftiu: Po lexoja më parë një intervistë të kryetarit të komunitetit mysliman të Firences, një intervistë e dhënë për “Corriera della Sera”, nëse nuk gabohem, dhe kishte një pyetje të ngjashme që i drejtohej, dhe imami i Firences thoshte me plot gojën që, mund të ndodhë që edhe njerëz me identitet islam, pra myslimanë në pamjen e parë, të përfshihen në veprime të cilat feja i ndalon, por kjo përgjegjësi personale nuk është përgjegjësi e fesë, nuk është përgjegjësi e besimit. Pra, nëse themi se myslimani nuk është i dhunshëm, nuk është terrorist, nuk është vrastar, grabitës dhe shumëçka tjetër, kjo nuk do të thotë se çdo mysliman në miliarda myslimanë të botës janë të gjithë të një kallëpi.

Unë them se një mysliman i pjekur, i matur dhe i formuar siç duhet, mbi bazat e Kuranit dhe mësimeve të fesë, asesi nuk mund të jetë i dhunshëm, arrogant apo terrorist. A janë myslimanët terroristë? Nuk janë! A ka terrorizëm islamik? Nuk ka terrorizëm islamik! A ka ekstremizëm në islam? Nuk ka ekstremizëm islami! Ka ekstremizëm në interpretime. Kjo është çështje njerëzore dhe nuk është çështje që lidhet me besimin drejtpërdrejt, ka edhe verbëri, ka edhe keqlexim të fesë, ka këto janë çështje të cilat kërkojnë një diskutim shumë të gjerë në detaje.

(GazetaShqiptare – 24/1/2017)

EGESTA, STUDIUESJA SHKODRANE QË PO HABIT EUROPËN



Q uhet Egesta Lopçi dhe ka mbaruar studimet në Bologna ku prej vitesh është e angazhuar në fushën kërkimore onkologjike në Itali pranë Istituto Clinico Humatinas. Gjatë kësaj periudhe ka botuar një sërë artikujsh shkencorë dhe është bashkautore në mjaft libra të profilit.

Egesta mishëron shembullin e suksesshëm të studentëve shqiptarë në Itali, megjithëse ky vend akoma nuk e ka vizionin e duhur për nevojën e investimit në fushën kërkimore, në mënyrë që të parandalohet largimi i trurit apo të joshet potenciali i huaj. Duke e lënë mënjanë Italianë në problemet e veta, Egesta, për më tepër, është shembulli i



heshtur i një myslimaneje të devotshme, që, ndonëse e emigruar në një vend tradicionalisht katolik dhe me laicitet të konsoliduar, nuk e fsheh aspak besimin e saj, dhe ndërkohë, pavarësisht kësaj, ajo shpërblehet pa hezitim për përkushtimin kërkimor, gjë që nuk ndodh në Shqipëri me bashkëfetarët e saj.

Ndërsa botimet e saj dhe kërkimet shkencore ndaj sëmundjes se kancerit gjejnë shteg për publikim në revista prestigjioze.

(marrë nga: www.eetimes.al)

MESKINITETET KURRË NUK KANË QENË VLERA!

Nuk e kam kuptuar asnjëherë se përse akoma sot, dikush, gjoja në emër të kombit dhe vlerave kombëtare, na bën filozofi e histori, mbështetur mbi osmanofobi, duke mbjellur urrejtje në mes nesh?

Islami tek ne shqiptarët ka mbërritur para osmanëve, ndërsa në Hilafetin Osman, ne shqiptarët u bëmë me famë, (ndoshta, si kurrë më parë e asnjëherë më pas në histori), udhëheqës, drejtues, komandantë, vezirë e kryeministra, (por jo vetëm)!

tuaj dhe unë timen!", është balsami që Kur'ani Famëllartë i ofron gjithësisë për të jetuar në harmoni në diversitet!

Ndërsa, të vazhdosh të bësh propagandë urrejtjeje, mosrespekti dhe të tejkalosh normat e logjikës në përballje me tjetrin, besimin, bindjen, argumentin dhe qasjen e tij ndaj fakteve, është pa asnjë dyshim meskinitet banal, që i kthehet mbrapsht kujt do që e promovon si vlerë! Meskinitet kurrë nuk kanë qenë vlera!

Në fakt, unë jam i bindur se ky model



XHAMIA E SULLTAN MEHMET FATIHUT, SHKODËR



Përse këtij pishtari të urrejtjes i mbahet ende fitili ndezur?! (Unë e kuptoj shumë mirë, por nuk kam ç'të bëj, kështu e ka kjo punë, disa vegjetojnë në moçalishtet e fanatizmit të verbër dhe ekstremizmit në të menduar e arsyetuar! Gjynah!)

Nga ana tjetër, unë nuk e kam për borxh t'i jap llogari askujt se kë dua e kë vlerësoj në bindjet dhe besimin tim, as në vokacionin tim kombëtar!

Të bekuarit, në paralajmërimet e Ma të Dashtunit tim, Hz. Muhammedit (a.s), Sulltan Mehmet Fatihut, nuk mund të mos i them Fatih (Çlirimtar), as se ma kërkon një analist, as se më shan për të një historian, as se ma përmend tash e parë një anonim që për mua nuk vlen asnjë grosh!

Do ju respektoj të gjithëve në bindjet tuaja, edhe kur gënjeni, edhe kur mashtroni, edhe kur thonë ca të vërteta që vetëm ju i besoni dhe nuk do ju kthej përgjigje, se kështu jam edukuar! Se, në fund të fundit nuk jua kam as për borxh!

Gjithashtu, kushdo që përpiket të fusë hundët në këto punë, e mëshiroj dhe më dhimbset me zemër, vallahi! "Ju keni fenë

mahluku, vuan në thelb islamofobinë, që prej kohësh, të shumtë ia kanë mëkuar këtij populli, mjerisht...!

Unë me zemër i ftoj në Islam, me bindjen se do të gjejnë shërim të plotë të komplekseve, që ua bëjnë jetën vner e inat!

All-llahumme udhëzoji zemrat e tyre drejt Dashnisë Tande dhe përuljes para mrekullive të besimit!

Për fund, monumenti i kulturës në kalanë e Shkodrës është xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut! Këtë ma thonë faktet historike, logjika dhe arsyetimi. Me këtë, nuk po provokoj njeri, aq më pak të nxis çfarë se kam as në gen, as në besim, as në edukimin tim familjar, qytetar e identitar!

I pëlqeu kujt i pëlqeu, e pranoi kush e pranoi, e refuzoi kush e refuzoi, heshti me turp kush heshti, bëri protagonistin kush bëri, u cyt kush u cyt, u përpëliti në zamallahinë e provincializmit kush u përpëliti!

O Zot, bëhu Dëshmitar!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 28 janar 2017



**Pejgamberi (a.s)
KA THËNË:**

*"Sadekaja
më e pëlqyer
është të mësojë
njeriu një dije,
pastaj t'ia
mësojë atë
vëllasë së tij
musliman!"*

(Ibn Maxheh, nga Ebu Hurejra)

KRYEMINISTRI KANADEZ, TRUDEAU: KANADAJA DO T'I PRANOJË REFUGJATËT PA DALLIM FEJE

Kryeministri i Kanadasë në llogarinë e tij zyrtare në Twitter reagoi pas Trump vendosi ndalimin e vizave për refugjatët nga vende kryesisht muslimane.

Pasi presidenti i zgjedhur amerikan Donald Trump ndaloi hyrjen e refugjatëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), kryeministri i Kanadasë Justin Trudeau i porositi refugjatët: "Kanadaja do t'u pranojë", raporton Anadolu Agency (AA).

Kryeministri i Kanadasë në llogarinë e tij zyrtare në Twitter reagoi pas Trump vendosi ndalimin e vizave për refugjatët nga vende kryesisht muslimane.



"Ata që largohen nga persekutimi, terrori dhe puna dëshiroj t'i porosim: Kanadaja do t'u pranojë, pavarësisht nga feja. Diversiteti është forca jonë. Mirë se vini në Kanada", shkroi Trudeau. (www.radiojehona.al)

LINDSAY LOHAN PRITET NGA PRESIDENTI ERDOĞAN DHE BASHKËSHORTJA E TIJ

Në pallatin presidencial në Ankara, aktoria e famshme Lohan ishte e shoqëruar nga 7-vjeçarja siriane Bana Alabed, e cila u bë e njohur botërisht për titujt e lajmeve të cilët i referoheshin postimeve të saj në Twitter nga Halepi i rrethuar.

Sipas lajmit të Agjencisë Turke të Lajmeve Anadolu Aktorja e famshme amerikane, Lindsay Lohan ka takuar mbrëmë në Ankara presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan dhe Zonjën e Parë, Emine Erdogan.

Në pallatin presidencial në Ankara, Lohan ishte e shoqëruar nga 7-vjeçarja siriane Bana Alabed, e cila u bë e njohur botërisht për titujt e lajmeve të cilët i referoheshin postimeve të saj në Twitter nga Halepi i rrethuar.

Gjatë vizitës, aktoria me famë mbante një shenjë dalluese "simbol", me ngjyrë të kaltër me citatin e famshëm të Erdoğan "Bota është më e madhe se pesë", të cilin ia prezantoi presidentit dhe zonjës së Parë.

Thënia e Erdoganit ka të bëjë me pesë shtetet e përhershme anëtare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të cilët kanë mekanizmin e vetos.

Kohët e fundit, amerikanja e famshme ka shfaqur interesin e saj për



të kontribuar në përpjekjet që bëhen për refugjatët sirianë në Turqi.

Më herët, në shtator të vitit të kaluar, Lohan qëndroi në Turqi ku vizitoi refugjatët sirianë në një spital të Stambollit, ndërsa më vonë në tetor, ajo përsëri vizitoi Turqinë, më konkretisht një kamp refugjatësh sirianë në krahinën Gaziantep.

Ajo në mënyrë të vazhdueshme ka lavdëruar përpjekjet e Turqisë për të strehuar 3 milionë refugjatë sirianë.

"Vendet evropiane dhe Shtetet e

Bashkuara të Amerikës duhet të marrin më shumë përgjegjësi për krizën e refugjatëve, dhe të mbështesin Turqinë në këtë drejtim", kishte thënë Lohan gjatë qëndrimit të mëparshëm në Turqi.

Ndërkohë, për vogëlushen siriane ky ishte takimi i saj dytë me presidentin dhe Zonjën e Parë, të cilët në dhjetor të vitit 2016, pritën Banën dhe familjen e saj në pallatin presidencial.

(www.radiojehona.al)



Vullnet Pishtari
student, Bursa

ULLU XHAMI, VEND KU KOHA NDAL...

drejtojë njëriu i dashur i Bursës i njohur me emrin Somunxhu Baba, i cili foli për tefsirin e 7 ajeteve të sures Fatiha. Xhemati mbeti i magjepsur prej këtij hatibi dhe nga modestia e madhe që kishte ky njëri u detyrua të largohej nga qyteti. Dita kur u hap për ibadet Ullu Xhamia ishte dita kur u largua Somunxhu Babai nga Bursa.

Imami i parë i kësaj xhamie Sulejman Çelebiu, gjatë mbajtjes së vasit në mamber shprehet e thotë që të gjithë pejgamberët e Zotit janë të barabartë dhe një pjesë e xhematit reagojnë kundër kësaj fjale. Me qëllimin e mirë, që të tregojë veçantitë dhe vlerën e madhe të pejgamberit të fundit të Zotit, Muhammed Mustafasë fillon shkrimin e veprës më të madhe të asaj kohe, e cila u bë e njohur në të gjithë vendin dhe jo vetëm; Mevludit Sherifë. Vepër kjo e shkruar në vitin 1409.

Në një kohë që jeta në Bursa vazhdon dhe ecën me hapa galopant, kjo ndërtesë e vjetër ka mbetur simboli i një periudhe të shenjtë. Si ditën e parë edhe sot, me dashuri dhe qetësi i pret mysafirët e saj. Është zemra dhe shpirti i këtij qyteti, Ullu Xhamia!

Sulltani i asaj kohe, Yilldërëm Bejaziti, para se të niset për luftë i drejtohet me një dua të sinqertë Allahut dhe betohet se nëse do ta fitojë këtë luftë, do të ndërtojë 20 xhami. Dhe, fjalën e dhënë, sigurisht që e mban. Ndërtoi një xhami madhështore me 20 kupola...

Kur filloi ndërtimi i kësaj xhamie, a thua e ka imagjinuar Yilldërëm Bejazit Hani që ka për të qënë një ndër 5 xhamitë më të rëndësishme të botës islame?! A thua e ka imagjinuar që në mamberin e kësaj xhamie do të fillonte të shkruhej vepra më e madhe për sulltanin e sulltanëve, Muhammedin (a.s.)?! A thua e ka imagjinuar që në këtë xhami do të shkelin këmbët e shumë besimtarëve nga mbarë bota?!

3 vite zgjati ndërtimi i saj dhe në vitin 1399 në një dite të xhuma, me një ceremoni ashtu siç i ka hije kësaj ndërtese madhështore u bë inagurimi i saj. Hutben e parë pati nderin ta

Kjo xhami ka një planimetri drejtkëndëshe, me gjatësi 55m dhe gjërësi 69m, është vazhdimi i traditës së Omerit (r.a) në ndërtimin e xhamiave të mëdha për tu shërbyer besimtarëve për tubimin në ditën e xhuma. Për ndërtimin e saj është vënë në dispozicion 5000m².

Një nga të veçantat e kësaj xhamie është shadërvani, i cili ndodhet në mesin e saj. Kupola përmbi shadërvan është më ndryshe se të tjerat, është e mbuluar me xham dhe e tillë shërben që xhamisë ti përhapet drita në të gjitha anët njëlloj. Shadërvani është 16 këndësh dhe uji në të rrjedh prej 3 niveleve të ndryshme dhe këto nivele kanë një ndarje prej 33 pjesësh, aq sa numri i tespive.

Xhamia ka 3 dyer kryesore, secila e punuar me një stil të rradhë me mermer në lindje, perëndim dhe në veri të

saj. Nga cilado derë që të hysh gjëja e parë që të shfaqet para syve është shadërvani.

Një tjetër nga veçoritë e kësaj xhamie është edhe mamberi, i cili është i ndërtuar prej 6666 copave të drurit të arrës pa përdorur qoftë dhe një gozhdë të vetme. Në pjesën lindore të mamberit me dërrasë është i vizatuar sistemi diellor, ndërsa në pjesën perëndimore Galaktika.

Në muret e kësaj xhamie janë të shkruara 192 ajete, hadithe dhe dua me stilin e shkrimit të bukur, sanatit të quajtur Hatt.

Në vitin 1517, Javuz Sulltan Selimi ka sjellë nga Mekka e shëndritshme mbulesën e derës së Qabes dhe e ka vendos me dorën e tij në një qoshe të xhamisë, si atë ditë dhe sot ruhet me fanatizëm nga besimtarët.

Ullu Xhamia, është xhamia e parë në Perandorinë Osmane me dy minare. Nuk ka sistem ajrimi, por për pastrimin e ajrit shërben shadërvani prej të cilit rrjedh uj vazhdimisht. Në oborrin e saj ka 3 shadërvanë të vegjël të cilët shërbejnë për të marrë abdes. Në anën perëndimore të saj ka një çeshme, nga e cila vazhdimisht rrjedh ujë i freskët, i cili ua heq etjen jo vetëm vendasve, por edhe turistëve, të cilët vijnë ta vizitojnë këtë vend të mrekullueshëm.

Kush e viziton qytetin e Bursës, me patjetër duhet të jetë edhe misafir i kësaj xhamie sepse është një vend që të fal paqe dhe qetësi. Kjo xhami madhështore ka një frymë të shenjtë e cila e përqafon shpirtin e njëriut, mbart histori dhe të mbush me iman. Nuk ka një të dytë si Ullu Xhamia...

Bursa, Janar 2017



MEJTEPI I IM...XHAMIA GOLEM, RRETHINA

PAK HISTORI:

- Xhamia Golem, ndodhet në zonën administrative "Rrethina", Bashkia Shkodër. Përbëhet me rreth 400 familje, të gjitha me përkatësi islame. Fiset më të mëdha janë: Hasaj, Dana, Kallamoqi, Rustaj etj.

- Pas rilejimit të besimit islam në vendin tonë, xhamia është ndërtuar në vitin 1994.

- Para ndërtimit të xhamisë, në periudhën 1991-1994, namazet dhe organizimi i mejtepeve janë zhvilluar në ambientet e ish-magazinave të institutit të Misrit.

- Kanë shërbyer si imam dhe mësues të mësim-besimit në periudha të ndryshme: Kujtim Cufaj, Lutfi Ballëku (nga Prizreni), Astrit Lekaj, Indrit Cani, Haxhi Shabani, Siditë Halluni (mësuese), Admir Temja dhe aktualisht Edvin Çela.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar 14 kurset fetare të besimit nga 1991-2017 është: 442 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadrin e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim besimit, drejtuesi i tij, teologu Arben Halluni më 14.01.2017, zhvilloi një takim pune në xhaminë Kullaj.

Teologu Halluni në fillim mbajti një bisedë me nxënësit e xhamisë, duke u



folur për rëndësinë që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që mbartim për të përcuar te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të

ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë dhe harmonike më të gjithë krijesat e Zotit Fuqplotë.

Më pas drejtuesi arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi i pasionuar H. Kujtim Cufaj dhe nevojat që ka xhamia për mirëmbajtjen e këtyre aktiviteteve mjaft të rëndësishme arsimore dhe edukative. Në këtë mejtep që ishte ndarë në tre grupe, me pjesëmarrje 40 nxënës zhvillohen lëndët si: Ilmihal, Kur'an-abetare, hadith dhe edukatë islame.



Sri Lanka është një ishull në jug të Azisë me një sipërfaqe prej 65,610 km². Ka një popullsi me mbi 20 milion banorë dhe njihet si shtet multikultural dhe me fe të ndryshme. Feja islame në Sri Lankë zë vendin e tretë në mesin e feve të tjera.

Edhe pse në skajin tjetër të globit dhe shumë larg vendit tonë, imami nga Shkodra, H. Jetmir Braçi dhe babai i tij kanë kryer një vepër bamirësie shumë të çmueshme për banorët e fshatit Mahamaaru të qytetit të Kinnijas (Kinniya), Sri Lanka.

Ata të dy kanë siguruar ujë të pijshëm për banorët e këtij fshati, duke ndërtuar infrastrukturën përkatëse për hapjen e një pusi uji dhe ndërtimin e një çezmeje dhe një vend abdesti, pranë xhamisë "Enuer".

Fshati Mahamaaru ka afërsisht 400 shtëpi dhe me një popullsi prej një mijë banorësh. Përpara se të ndërtohej pusi, banorët e këtij fshati duhet të bënin 4 km rrugë larg për t'u furnizuar me ujë.

IMAMI NGA SHKODRA, VEPËR BAMIRËSIE NË SRI LANKA



Myftinia Shkodër shpreh falënderimet dhe mirënjohjen e saj të thellë për këtë vepër bujare të imamit të nderuar dhe familjes së tij.

10 VJETORI I XHAMISË SË PARRUCËS, MYFTIU TAKOI TELOGËT

Pasdreken e së xhumasë, më 6 janar 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, diskutoi me një grup imamësh teologë programin e aktiviteteve të larmishme, me rastin e përkujtimit të 10 vjetorit të inaugurimit të xhamisë së re të Parrucës.

Myftiu theksoi se aktivitetet në fjalë janë pjesë e shfaqjes së mirënjohjes dhe falënderimeve komunitare ndaj All-llahut të Madhëruar, që e mundësoi që Parruca ta ketë këtë xhami të bukur, si simbol shekullor i Islamit dhe si dëshmi e identitetit islam të kësaj lagjeje të vjetër të Shkodrës.

Ai theksoi se programi do të ndërthurë vase dhe hytbe të përjavshme, ku do të angazhohen imamët teologë, sipas një kalendari të planifikuar më parë.

Gjithashtu, në këtë takim u diskutua edhe për detajet e Konferencës së 6-të të përvitshme të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, për të cilën do të zhvillohet një takim i dytë brenda kësaj jave.

Ndërkohë, më 7 janar 2017, Këshilli i Myftinisë Shkodër, nën drejtimin e Myftiut, diskutoi mbi programin e ngjeshur të aktiviteteve thirrëse, sidomos në prag të përkujtimit të 10 vjetorit të inaugurimit të xhamisë së Parrucës.

Gjithashtu, në këtë mbledhje u diskutua edhe për zhvillimet më të reja të Thirrjes Islame në Shkodër.

10 VJETORI I XHAMISË SË PARRUCËS
Kalendari i derseve dhe i hytbeve
12.01.2017 - 23.3.2017, NË XHAMINË E PARRUCËS

DERSE (çdo të enjte pas akshamit)		HYTBE	
12.1.2017	Imam Muhamed Sytari	13.1.2017	Lavdrim Hamja
19.1.2017	Lavdrim Hamja	20.1.2017	Ruzhdi Plangaj
26.1.2017	Ruzhdi Plangaj	27.1.2017	Adem Pizga
02.2.2017	Idmir Plaku	03.2.2017	H. Edmir Smajlaj
09.2.2017	Adrian Uraj	10.2.2017	Ervil Kuçi
16.2.2017	Ervil Kuçi	17.2.2017	Idmir Plaku
23.2.2017	Adil Cukali	24.2.2017	Durim Kasemi
02.3.2017	Altin Nikshiqi	03.3.2017	Adil Cukali
09.3.2017	Naim Drijaj	10.3.2017	Arben Halluni
16.3.2017	Durim Kasemi	17.3.2017	Naim Drijaj

MYFTINIA SHKODËR NË NDIHMË TË FAMILJES MULIU

Ditën e martë, më 24 janar 2017, Myftinia Shkodër iu bashkua solidarizimit publik të ndërmarrë një ditë më parë nga Tv1Channel, në ndihmë të familjes Muliu, në lagjen Guerrile.

I pranishëm në këtë vizitë ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi para mediave të pranishme se, është e domosdoshme të gjendemi përherë e më shumë pranë familjeve në nevojë, që kanë probleme e halle, në mënyrë që të dëshmojmë solidaritetin dhe humanizmin e besimit dhe qytetarisë.

Myftiu i bëri thirrje institucioneve dhe bizneseve të qytetit që të angazhohen me bamirësinë e tyre karakteristike, që të koordinohet ndihma dhe solidarizimi me familjet në nevojë në Shkodër e përtej saj.

Myftinia Shkodër i dorëzoi familjes



Mulia një sasi ndihmash ushqimore dhe një ngrohës të domosdoshëm, sidomos në këto ditë të ftohta të dimrit.

Myftinia Shkodër falënderon mediat vizive, që herë pas here transmetojnë lajme solidarizuese me familje në nevojë.

DREJT PËRFUNDIMIT XHAMIA E RE NË SHTUF


Paraditën e së mërkurës, më 25 janar 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një inspektim në terren për të parë nga afër gjendjen e punimeve për xhaminë e re në fshatin Shtuf, Ana e Malit.

Punimet për xhaminë e re të Shtufit nisën gjatë Ramazanit të kaluar, falë

bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC).

Sot, pjesa kryesore e punimeve për xhaminë e re është kryer, ndërkohë pritet që shumë shpejt të nisë faza përfundimtare e punimeve të brendshme.


**XHAMIA E RE,
SHTUF - ANA E MALIT**



**Pejgamberi (a.s.)
ka thënë:**

**"TRE GJËRA; kush
i posedon, ka shijuar
ëmbëlsinë e besimit:
Të jetë All-llahu
dhe i dërguari i Tij
më të dashur për të
sesa kushdo tjetër,
ta dojë tjetrin,
për asgjë tjetër vetëm
se për hir
të All-llahut, si dhe
të urrejë kthimin në
femohim, pasi All-llahu
e shpëtoi prej tij,
siç urren të hidhet
në zjarr!"**

(Ahmedi, Bukhariu, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxheh, nga Enesi)



Sado që fëmijët të dëgjojnë për
MORALIN E BUKUR,
ai do të ngelet i mjegullt në mendjet e tyre,
për aq kohë sa ata,
nuk e shohin këtë moral të trupëzuar
tek më të rriturit!

MYFTINIA
SHKODËR



www.myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org